



Public Health  
England

**NHS**

Një udhëzues  
për



# vaksinimin tuaj kundër COVID-19



**COVID-19 immunisation**  
Protect yourself.

## Çfarë është Covid-19 apo Koronavirusi?

Covid-19 është një sëmundje e re. Ndonjëherë quhet koronavirus.



Shumica e njerëzve do të bëhen më mirë nga Koronavirusi në shtëpi, por disa njerëz mund të bëhen shumë keq dhe duhet të shkojnë në spital



Fatkeqësisht, ndonjëherë njerëzit mund të vdesin nga Koronavirusi

## Disa shenja të Koronavirusit janë:

Një kollë e re dhe vazhdoni të kolliteni




Një temperaturë e lartë



Ndjësia e aromave ose shijes tuaj zhduket ose ndryshon



Nëse keni simptomat e mësipërme, qëndroni në shtëpi dhe caktoni që të bëni një test



Nëse keni nevojë për më shumë informacion mbi simptomat, vizitoni [www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/symptoms](https://www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/symptoms)


Nëse nuk mund të përdorni faqen e internetit të NHS, telefononi 119 falas



## Rreth vaksinës



Vaksina kundër Koronavirusit është një injeksion



Ju do të keni nevojë për 2 injeksione të vaksinës, të cilat do të bëhen në një distancë prej 3 deri në 12 javë



Vaksina është testuar për t'u siguruar që është e sigurt

## Kush duhet t'i bëj vaksinat e Koronavirusit?

Disa njerëz kanë më shumë të ngjarë të sëmuren shumë më keq nga Koronavirusi sesa disa të tjerë



Nëse ju jeni një prej tyre, do t'ju ofrohet vakcina



### Disa njerëz që kanë më shumë të ngjarë të sëmuren keq:

Njerëzit që jetojnë në një shtëpi kujdesi për të moshuarit



Njerëz të moshës 65 vjeç e më lart



Të rriturit me sindromën Daun



Vaksina do t'u ofrohet gjithashtu të rriturve me këto gjendje shëndetësore:

Probleme me veshkën ose mëlçinë tuaj



Sëmundjet e zemrës



Disa probleme të trurit



Probleme serioze të frymëmarrjes si astma (përdorimi shpesh i pompave me steroide)



Vendimi për marrjen e vaksinës do të varet nga gjendja që keni dhe sa serioze është

Kjo listë nuk i mbulon të gjithë personat

Nëse ka më shumë të ngjarë të sëmureni, duhet t'ju ishte thënë nga mjeku juaj



Nëse keni një gjendje që ju bën të ketë më shumë të ngjarë të sëmurëni më tepër nga koronavirusi kjo quhet të jesh "Klinikisht jashtëzakonisht i prekshëm"

Kjo do të thotë që ju do të jeni në gjendje të merrni injeksionin kundër koronavirusit më herët sesa personat e tjerë



Personeli shëndetësor dhe i kujdesit shoqëror gjithashtu do të jetë në gjendje të bëjnë vaksinën



Kujdestari/ja juaj kryesor(e) është në gjendje të bëjë vaksinën



Nëse jeni një punonjës i paguar i kujdesit për një person të prekshëm, gjithashtu do të jeni në gjendje të merrni vaksinën



## Si ta dini nëse duhet të bëni një vaksinë

Mjeku i përgjithshëm duhet të jetë në gjendje t'ju tregojë nëse duhet ta bëni vaksinën kundër Koronavirusit

Disa njerëz mund të marrin një letër ose një telefonatë për t'i ftuar ata për vaksinimin e tyre.



## Si të rezervoni takimin tuaj

Letra juaj e ftesës do të shpjegojë se kë të telefononi për takimin tuaj

Përdorni telefonin për të caktuar takimin tuaj



Do t'ju njoftohet se ku dhe kur të drejtoheni për vaksinën tuaj



Disa njerëzve mund t'u kërkohet të shkojnë në një qendër vaksinimi për të bërë vaksinën e tyre



Nëse nuk jeni i sigurt, flisni me mjekun tuaj (mjekun e familjes)



## Çfarë të bëj më tej?


Kur të keni bërë injeksionin e parë, do t'ju tregohet se ku dhe kur të shkoni për injeksionin tuaj të dytë



Duhet të keni një kartë regjistrimi ku të jetë shënuar takimi juaj i radhës për një takim pas 3 deri në 12 javë kohë



Megjithëse doza e parë do t'ju japë mbrojtje të mirë, ju duhet doza e dytë për të marrë një mbrojtje më të qëndrueshme



**Karta do të jetë kështu** Mbani të sigurt kartën tuaj dhe sigurohuni që të shkoni në takimin tuaj të radhës për të marrë injeksionin tuaj të dytë

Don't forget your  
**COVID-19 vaccination**

NHS

**Make sure you keep this record card in your purse or wallet**

For more information on the COVID-19 vaccination or what to do after your vaccination, see [www.nhs.uk/covidvaccine](https://www.nhs.uk/covidvaccine)

**COVID-19 immunisation**  
Protect yourself.



Name

1

Name of vaccine:

Batch no:

Date vaccine given:

Don't forget to attend your appointment to have your second dose of vaccine. You will have the best protection after two doses.

**Second appointment date:**

2

Name of vaccine:

Batch no:

Date vaccine given:

Public Health England gateway number: 2020311. Product code: COV2020311

**Ndiqui udhëzimet aktuale [www.gov.uk/coronavirus](https://www.gov.uk/coronavirus)**

## Sa kohë do të duhet të funksionojë vaksina?

Mund të duhen disa javë që vaksina t'ju mbrojtë



## A funksionon vaksina për të gjithë?

Vaksina nuk i ndalon plotësisht të gjithë që të kapin Koronavirusin, por nëse e kapni Koronavirusin nuk duhet t'ju bëjë aq keq nëse keni bërë vaksinën



## Alergjitë

Nëse keni alergji serioze, duhet të kontrolloni me mjekun tuaj nëse është e sigurt për ju që të merrni vaksinën



Ju mund të keni një alergji serioze nëse mbani një epipen



## Shtatzënë apo mendoni se mund të jeni?



Disa gra që janë shtatzënë ose ushqejnë me gji mund të bëjnë vaksinën



Disa mund të presin pasi të kenë lindur fëmijën e tyre



Flisni me mjekun tuaj të përgjithshëm ose maminë për këtë


**Vaksina është e sigurt nëse keni probleme me sistemin tuaj imunitar (kjo është kur trupi juaj e ka të vështirë të luftojë infeksionet)**

## Efektet anësore të vaksinës

Efektet anësore shumë të zakonshme përfshijnë:



Krahu juaj ndjehet i rëndë ose i lënduar atje ku keni bërë injeksionin



Ndiheni në gjendje të keqe ose sikur ju ka kapur gripi



Ndiheni të lodhur



Keni dhimbje koke

## Nëse ndieheni se keni temperaturë (sikur keni shumë të nxehtë ose shumë të ftohtë) duhet të:

Pushoni



Merrni paracetamol



Ju duhet të ndieheni më mirë në më pak se një javë



## Ju nuk mund të merrni Koronavirusin nga vaksina, por është e mundur që të keni marrë Koronavirusin dhe të mos e kuptoni deri pas takimit tuaj të vaksinimit

Nëse ndieheni shumë dobët ose shqetësoheni se mund të keni Koronavirusin, telefononi në 111 ose shkoni në faqen e internetit të 111



Sigurohuni që i tregoni 111 se sapo keni bërë vaksinën tuaj të Koronavirusit



Nëse NHS 111 ju thotë të vizitoheni nga një mjek ose një infermier, sigurohuni që t'i tregoni edhe atyre rreth vaksinimit tuaj

Nëse keni mundësi, tregojuni kartën tuaj të vaksinimit



Nëse mendoni se keni një efekt serioz anësor nga vaksina, mund t'a raportoni duke përdorur skemën e kartës së verdhë

Sistemi i kartës së verdhë të Koronavirusit është një faqe në internet ku mund të raportoni çdo efekt anësor nga vaksina [coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk](https://coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk)

Mund të keni nevojë për mbështetje për të hyrë në këtë faqe në internet



## Unë kam bërë vaksinën time të gripit, a kam nevojë edhe për vaksinën kundër Koronavirusit?



Flu vaccine



COVID vaccine

Është e rëndësishme të bëni vaksinën e gripit edhe vaksinën kundër Koronavirusit



Ju duhet të prisni 1 javë pasi të keni bërë vaksinën e gripit para se të merrni vaksinën kundër Koronavirusit

## Çfarë duhet të bëj nëse nuk jam mirë kur të jetë takimi im i radhës?



Nëse nuk ndiheni mirë, prisni të bëni vaksinën tuaj kur të ndiheni më mirë



Ju duhet të përpiqeni ta bëni atë sa më shpejt të jetë e mundur. Mund të telefononi në të njëjtin numër që keni përdorur për të caktuar takimin tuaj të parë



Ju nuk duhet të merrni pjesë në një takim vaccine nëse po vetë-izoloheni, jeni duke pritur për një test Koronavirusi apo nuk jeni i sigurt nëse jeni në gjendje të mirë shëndetësore


## A mund t'a infektoj dikë me koronavirus, pasi të kem bërë vaksinën?



Vaksina nuk mund t'ju infektojë me Koronavirus



Bërja e vaksinës ju bën të keni më pak të ngjarë të sëmurëni shumë nga Koronavirusi



Ne ende nuk e dimë nëse kjo do t'ju ndalojë të kapni dhe kaloni virusin

## Ju ende duhet të:



Qëndroni larg njerëzve të tjerë (distancimi shoqëror)



Vini një maskë fytyre



Lani duart me kujdes dhe shpesh

Vaksinimi, ndihma në mbrojtjen e njerëzve më të prekshëm.

© E drejta e autorit Crown 2021. Kodi i produktit COV2020344AL Albanian. 1p 5M JANAR (APS) 2021. Shëndeti Publik në Angli numri i portalit 2020619. Ju mund të porosisni më shumë nga këto broshura këtu [www.healthpublications.gov.uk](http://www.healthpublications.gov.uk)